

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M


Nr. 04, datë 27.02.2019

Për miratimin e “Pasqyrave financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2018”

Në mbështetje të nenit 7, pika 2 dhe 3, nenit 52 pika 1, shkronja “I”, nenit 53, pika 5, shkronja “ë”, dhe nenit 62, pika 1 dhe pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 8, pika 2, shkronja “I” të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të miratojë “Pasqyrat financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2018”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për dërgimin e pasqyrave financiare të audituara në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Këshillin e Ministrave dhe Autoritetin Mbikëqyrës, sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.



KËSHILLI DREJTUES

3. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Sektori i Financës dhe Investimeve.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar